REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 36 datë 24.12.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "STRUKTURË ME FUNKSION HOTELIER DHE BANIMI 1-2 KAT MBI TOKË, ME 1-2 KAT NËNTOKË, ME TARRACË TË SHFRYTËZUESHME, PISHINA DHE MUR RRETHUES", ME VENDNDODHJE NË PALASË, BASHKIA HIMARË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvilluese shoqërisë "G&E Investment" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Strukturë me funksion hotelier dhe banimi 1-2 kat mbi tokë, 1-2 kat nëntokë, me tarracë të shfrytëzueshme, pishina dhe mur rrethues", me vendndodhje në Palasë, Bashkia Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë "G & E Investment" sh.p.k

2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.

3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuesit vetëm pas:
   a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
   b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.

4. Vendimi Nr. 24 datë 31.07.2024 dhe Vendimi Nr. 10, datë 04.10.2024 i Këshillit Kombëtar të Territorit, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.



Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTEVE

BLENDI GONXHJA

ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 26/05/ 2026